



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KRYETARI

Nr. 4132 Prot.

Tiranë më 30/11/2018

N J O F T I M

P Ë R

**THIRRJEN E MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË GJYQTARËVE PËR
ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT LARTË TË GJYQËSOR**

GJYQTARËVE TË TË GJITHA NIVELEVE

Në mbështetje të nenit 13 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pasi u njoha me listën e kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor, përcjellë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me datë 27.11.2018, sot më datë 30.11.2018 vendosa të thërras Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve.

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve duhet të zgjedhë 6 (gjashtë) anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve do t’i zhvillojë punimet në ambientet e Hotel Tirana International (Tiranë), ditën e mërkurë, më datë 12 Dhjetor 2018, ora 10.⁰⁰.

Sipas nenit 14/1 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, pjesëmarrja e gjyqtarëve në Mbledhjen e Përgjithshme për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përbën detyrim ligjor.

KRYETARI
XHEZAIR ZAGANJORI

